



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 467 prot.

Tiranë, më 17.11. 2017

V e n d i m

Nr. 21, datë 17 nëntor 2017

Për aprovimin në parim të

“DRAFT REFORMËS INSTITUCIONALE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE ROLIT TË
AKADEMISË SË SHKENCAVE”,

Drejtuar: Asamblesë së Akademisë së Shkencave;
Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike në Akademinë e Shkencave;
Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike në Akademinë e Shkencave;
Sektorit të bibliotekës dhe të botimeve shkencore; sektorit të financës; sektorit të personelit.

Për dajeni: KRYEMINISTRISË
Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë;

Mbështetur:

1. Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, nenet 9 dhe 10;
2. Statutit të Akademisë së Shkencave, nenet 15 dhe 16;
3. Rekomandimeve të *Procesit të Ballkanit Perëndimor - Procesi i Berlinit* (2015-2016, bashkëmbyllur);
4. Kodit evropian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor;
5. **V e n d i m i n** nr. 18, datë 11 shtator 2017 “*Për krijimin e komisionit të akademikëve (ad hoc) me mandat të plotë përfaqësimi nga asambleja e Akademisë së Shkencave për reformën në kërkimin shkencor dhe atë të Akademisë së Shkencave*”;
6. Vendimit Nr. 19, datë 31 tetor 2017 “*Për reformën institucionale të kërkimit shkencor dhe të ardhmen e Akademisë së Shkencave*”;

Konstatohet se:

Në mbledhjen e saj të datës 17 nëntor 2017, ora 11: 00 Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, pasi provoi vlefshmërinë e organizimit të mbledhjes përmes konstatimit të pjesëmarrjes dhe kuorumit të anëtarëve të pranishëm, në përputhje me rendin e ditës si më poshtë i bërë publik më datën 3 nëntor 2017:

1. Prezantimin nga ana e komisionit ad-hoc të akademikëve, të dokumentit lidhur me reformimin e sistemit institucional të kërkimit shkencor dhe të Akademisë së Shkencave.
2. Diskutime.
3. Miratimi i dokumentit të paraqitur me votim nga asambleja.

Sa më sipër, anëtarët e asamblesë, pasi u njohën dhe dëgjuan paraqitjen e zgjeruar të draft-dokumentit të hartuar nga Komisioni Ad Hoc i paraqitur nga akademik Apolon Baçe-kryetar i komisionit; pas diskutimeve të akademikëve Beqir Meta, Vasil S. Tole, Floresha Dado, Anesti Kondili, Nestor Thereska, Neki Frashëri, Kosta Brajaba, Salvator Bushati, Floran Vila, Ilirjan Malollari, Fatos Kongoli, Dhimitër Haxhimihali, Gjovalin Shkurtaj, Muzafer Korkuti dhe prof. As. Dr. Andi Rrëmbeci, bashkë kryetari i Akademisë së të Rinjve i ftuar në mbledhje; sa më sipër në unanimitet asambleja;

VENDOSI:

1. Aprovimin në parim të propozimit “DRAFT I REFORMËS INSTITUCIONALE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE ROLIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE”, i cili do të shërbejë si bazë për reformimin e pranuar dhe të nisur tashmë, në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave dhe grupin e reformës pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Aprovimi i dokumentit të bëht i njohur për publikun përmes aprovimit të një “Deklarate” për shtyp.
2. Komisioni ad hoc të reflektojë në draftin e aprovuar edhe sugjerimet e bëra në mbledhjen e asamblesë si dhe ato të dërguara me shkrim nga akademikët, brenda ditës së hënë, datë 19 nëntor 2017.
3. Drafti të përcillet zyrtarisht pranë grupit të punës të reformës institucionale të kërkimit shkencor të ngritur pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
4. Asambleja aprovoi kandidaturën e z. Apolon Baçe (të propozuar nga komisioni ad hoc), si anëtar në grupin e reformës institucionale të kërkimit shkencor, në vend të akademikut Muzafer Korkuti që ka dalë në pension.
5. Me propozim të akademik Muzafer Korkuti, asambleja vendosi që të ridërgojë pranë Këshillit të Ministrave praktikën “Për përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe në funksione publike”. (Kërkesë propozim, projekt VKM dhe “Relacionin” përkatës të hartuar nga ASH-ja)
6. Ngarkohet specialisti i shërbimit IT për publikimin e këtij vendimi edhe në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Akademisë së Shkencave.
7. Ngarkohet Këshilli Ekzekutiv për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar Shkencor

Vasil S. Tole

Vasil S. Tole

